


5



ARJ.nr.42/2016

Gjykata Supreme e Kosovës, kolegji i përberë nga gjyqtaret: Enver Peci, kryetar, Erdogan Haxhibeqiri dhe Shukri Sylejmani, anëtar, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtorit profesional Sherif Krasniqi, si procesmbajtës, në kontestin administrativ të paditësit Korporata Energjetike e Kosovës (KEK), SH.a, në Prishtinë kundër të paditurës, Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale – Trupi Ekzekutiv i Inspektoratit të Punës(TEIP) në Prishtinë, me bazë juridike anulimi i vendimit, duke vendosur sipas kërkesës për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor të paditurit, të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, AA.nr.317/2016 te datës 25.10.2016, dhe Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative, A.nr.58/14 datë 14.07.2016, në seancën e kolegjit të mbajtur më 08.02.2017, mori këtë:

A K T V E N D I M

Hidhet si e pa lejuar kërkesa e të paditurës, Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale – Trupi Ekzekutiv i Inspektoratit të Punës në Prishtinë , për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor e parashtruar kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës- Departamenti për Çështje Administrative , AA.nr.317/2015 të datës 25.10.2016 dhe Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative, A.nr.58/14 datë 14.07.2016.

A r s y e t i m i

Me aktgjykimin e atakuar të Gjykatës se Apelit te Kosovës, AA.nr.317/2015 të datës 25.10.2016, është refuzuar si e pabazuar ankesa e të paditurës, Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale – Trupi Ekzekutiv i Inspektoratit të Punës në Prishtinë, e parashtruar kundër aktgjykimit te Gjykatës Themelore ne Prishtine-Departamenti për Çështje Administrative, A.nr.58/14 të datës 14.07.2016, me të cilin është aprovuar kërkesëpadia e paditësit dhe është anuluar vendimi i te paditurës, Nr.82/2013 i datës 03.12.2013, çështja është kthyer në rishqyrtim dhe rivendosje te e paditura.

E paditura kësaj gjykate ne afat ligjor i ka parashtrua kërkesë për rishqyrtim te jashtëzakonshëm te vendimit gjyqësorë, me te cilën ne tersi e konteston ligjshmërinë e aktgjykimet e instancave më të ulëta shkake të; shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës dhe zbatimit të gabuar të drejtës materiale, me propozim qe aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë, A.nr.58/2014 të datës 14.07.2016, të ndryshohet dhe të refuzohet në tërësi si e pabazuar kërkesëpadia e paditësit.

Gjykata Supreme e Kosovës shqyrtoi kërkesën për rishqyrtim te jashtëzakonshëm te vendimit gjyqësorë dhe në bazë të nenit 52 të Ligjit për Konfliktet Administrative, ka gjetur se:

Kërkesë është e pa lejuar.



Me dispozitën e nenit 24 par. 1 të Ligjit për Konfliktet Administrative është parapa që, kundër vendimit të formës së prerë të gjykatës kompetente për çështje administrative të shkallës së dytë, pala munde të parashtrijë Gjykatës Supreme të Kosovës, kërkesën për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor. Meqenëse me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë- Departamenti për Çështje Administrative, A.nr. 58/2014 dt.14.07.2016, është aprovuar kërkesëpatria e paditësit (KEK-ut), ndërsa është anuluar vendimi i të paditurës (MPMS- TEIP), çështja është kthyer te paditurës në rishqyrtim dhe rivendosje, ndërsa ky aktgjykim është vërtetuar me aktgjykimin e Gjykatës së Apelit - Departamenti për Çështje Administrative, konstatohet se vendimi nuk është i formës së prerë. Në këtë çështje administrative gjykata e shkallës së parë vendimin e të paditurës, nr.82/2013 dt. 03.12.2013 e ka kthyer në rishqyrtim dhe rivendosje për shkak të mangësive vendimit administrativ të paditurës të cekura në aktgjykim, në anën tjetër në bazë të nenit 65 të LKA-ës, gjykata e shkallës së parë e ka obliguar organin e paditur që në riprocedur në afat prej 30 ditësh, të veproj sipas vërejtjeve të dhëna në aktgjykim. E paditura nga shkresat e lëndës konstatohet se nuk ka vepruar sipas vërejtjeve të gjykatës ndërsa sipas nenit 65 të LKA-ës, parashihet karakteri i detyrueshëm i aktgjykimit nëse si në rastin konkret anulohet akti administrativ, kundër të cilit ka filluar konflikti administrativ. Në këtë dispozitë ligjore shprehimisht është parapa që, lënda kthehet në gjendjen në të cilin ishte para se të ishte nxjerrë akti i anuluar. Andaj në një situatë të kështillë procedurale, kjo gjykatë konsideron se procedura duhet filloj nga akti i ri administrativ i të paditurës në mënyrë që pastaj të vazhdoj konflikti administrativ sipas procedurës së paraparë në LKA.

Duke pas parasysh dispozitat e lartcekura të Ligjit për Konfliktet Administrative, pasi që nuk kemi të bëjmë me vendim të formës së prerë të gjykatës dhe çështja i është kthyer organit administrativ në rishqyrtim dhe rivendosje, kjo gjykatë e hidhi si të pa lejuar kërkesën për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor.

Nga si u tha me sipër, e në baze të nenit 52 par. 1 e lidhur me nenin 24 të Ligjit për Konfliktet Administrative u vendos si në dispozitiv të kësaj aktvendimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVES
Me 8 shkurt 2017, ARJ.nr.42/2016

Procesmbajtësi,
Sherif Krasniqi

